



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 56 shkronja b të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, nenet 8 dhe 10.1 shkronja a) të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, pas vlerësimit nga ana e Këshillit organizativ i ngritur nga Kryetari i Komunës me vendim nr. 02-020/02-9139/17, datë 10.02.2017 dhe rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 02-020/04-5017/17, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, merr:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ-të KULTURO- ARTISTIKE DHE SPORTIVE PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE-AKTIVITETEVE ME RASTIN E SHËNIMIT TË DITËS SË PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 1

Për realizimin e programeve -aktiviteve kulturo-artistike dhe sportive, me rastin e shënimit të 17 shkurtit Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në shumë të gjithmbarshme prej 1750, mbështeten subjektet si vijon:

| | |
|--|--------|
| -Klubi i Karates " Karate Club –Podujeva" në Podujevë..... | 100 € |
| - SHKA " Josip Relat" | 1000 € |
| - OJQ " Labirinth" | 300 € |
| - S//Sprint liga..... | 350 € |

Neni 2

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogaritë e OJQ-ve – subjekteve të cekura si në nenin 1 të këtij vendimi.


Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-644/01-9813/17
Podujevë, 13 shkurt 2017



Kryetari i Komunës
Agim Veliu